



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Qeveria  
Vlada - Government  
Ministria e Integritit Evropian  
Ministarstvo Evropske Integracije - Ministry of European Integration  
Departamenti i së Drejtës së BE-së - Departament za Zakonodavstvo EU - Department of EU Law

# MANUAL PËR PLOTËSIMIN E TABELAVE DHE DEKLARATËS TË PËRPUTHSHMËRISË

## Përmbajtja

<u>1.....Hyrje</u>	<u>3</u>
<u>2.....Tabela e Përputhshmërisë Bashkimi Evropian – Republika e Kosovës</u>	<u>6</u>
<u>3.....Tabela e Përputhshmërisë Republika e Kosovës – Bashkimi Evropian</u>	<u>13</u>
<u>4.....Deklarata e Përputhshmërisë së Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Acquis të BE-së</u>	<u>19</u>
<u>5.....Udhëzime Shtesë</u>	<u>25</u>

# 1. HYRJE

Qëllimi i 'Manualit Për Plotësimin E Tabelave dhe Deklaratës së Përputhshmërisë' është që të pasqyrojë në mënyrë praktike plotësimin e TeP dhe DeP. Ky dokument është dinamik dhe do të përditësohet sipas nevojës me qëllim të rifreskimit me informata të reja dhe raste praktike të përpilimit të TeP dhe DeP.

Rekomandohet që të lexohet së bashku me 'Udhëzuesin praktik për Përafrimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian, i cili përmban sqarime te-orike dhe praktike për procesin e përafrimit të legjislacionit vendor me acquis të BE-së.

## 1.1. Çka janë Tabelat e Përputhshmërisë dhe Deklarata e Përputhshmërisë?

Tabelat e Përputhshmërisë (BE – Republika e Kosovës dhe Republika e Kosovës – BE) dhe Deklarata e Përputhshmërisë së Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Acquis të BE-së janë dokumente përcjellëse të projekt-akteve të institucioneve të Republikës së Kosovës. Këto janë dokumente pune krahasuese, të cilat pasqyrojnë shkallën e përputhshmërisë së një projektakti normativ vendor me Acquis të BE-së . Të njejtat kanë filluar të zbatohen në praktikë nga data 1 Janar 2014.

## 1.2. Cila është baza ligjore e këtyre dokumenteve?

- [Udhëzimi Administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative](#) - Neni 30;
- [Rregullore nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar](#) - Neni 14, dhe
- [Rregullore e Punës së Kuvendit e datës 29 Prill 2010](#) - Neni 54.

## 1.3. Cili është qëllimi i plotësimit të këtyre dokumenteve?

Qëllimi esencial i këtyre dokumenteve është **vlerësimi i nivelit të përputhshmërisë të një projekt akti normativ vendor me Acquis të BE-së**. Shprehimisht, Deklarata e Përputhshmërisë pasqyron në mënyrë të përgjithshme ndërlidhjen e projekt-aktit të caktuar me Acquis të BE-së dhe dokumentet e tjera strategjike, ndërsa Tabelat e Përputhshmërisë pasqyrojnë në mënyrë të detajuar (nen për nen) përputhshmërinë e projekt-aktit vendor me Acquis të BE-së dhe anasjelltas, duke dhënë një pamje të qartë të nivelit të përputhshmërisë.

## 1.4. Ku mund të gjenden modelet e këtyre dokumenteve?

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative, organi propozues i një projekt-akti duhet të plotësoj:

- Deklaratën e Përputhshmërisë duke u bazuar në Shtojcën 15 të këtij Udhëzimi, dhe
- Tabelën e Përputhshmërisë Republika e Kosovës – Bashkimi European duke u bazuar në [Shtojcën 16](#) të Udhëzimit dhe Tabelën e Përputhshmërisë Bashkimi European – Republika e Kosovës duke u bazuar në [Shtojcën 17](#) të Udhëzimit.

## 1.5. Kush i plotëson këto dokumente?

Tabelat e Përputhshmërisë dhe Deklarata e Përputhshmërisë plotësohen nga organi propozues gjatë procesit të hartimit ligjor, në mënyrë që të ndihmohet procesi i përafrimit ligjor dhe të mundësohet ofrimi i informatave konkrete në lidhje me shkallën e përputhshmërisë së një projekt akti normativ vendor me Acquis të BE-së.

*Fuqimisht rekomandohet që Tabelat e Përputhshmërisë të plotësohen nga hartuesit gjatë procesit të hartimit dhe jo më vonë nga zyrtarë të tjerë të cilët nuk kanë qenë pjesë e hartimit.*

<sup>1</sup>[http://mei-ks.net/repository/docs/Udhezime\\_Praktike\\_per\\_Perafrimin\\_e\\_Legjislacionit\\_Vendor\\_me\\_ate\\_te\\_BE-se.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/Udhezime_Praktike_per_Perafrimin_e_Legjislacionit_Vendor_me_ate_te_BE-se.pdf)

<sup>2</sup>Tërësia e legjislacionit të Bashkimit Evropian i cili përbëhet nga normat dhe praktika juridike, duke përfshirë legjislacionin primar dhe sekondar, si dhe aktet tjera ligjore, parimet, marrëveshjet, deklaratat, rezolutat, mendimet, objektivat dhe praktikatat institucionale dhe operative (duke përfshirë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, që aplikohen ndaj Bashkimit) qoftë ligjërisht të detyrueshme ose jo.

## 1.6. Për cilat akte duhet të plotësohen këto dokumente?

Tabelat e Përputhshmërisë dhe Deklarata e Përputhshmërisë duhet të plotësohen për çdo projekt akt ligjor dhe nënligjor të propozuar për miratim nga ana e organit propozues.

Vlen të theksohet se në rastet kur fusha e rregulluar me projekt aktin normativ vendor **nuk është fushë e cila në mënyrë specifike rregullohet me Acquis të BE-së**, atëherë nuk është e domosdoshme të plotësohen Tabelat e Përputhshmërisë, por vetëm Deklarata e Përputhshmërisë së Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Acquis të BE-së, në të cilën deklarohet se nuk ka legjislacion të BE-së që e rregullon këtë fushë, ashtu siç është e paraparë me legjislacionin në fuqi.

## 1.7. Cilat janë hapat që duhet të ndërmerren pas plotësimit të këtyre dokumenteve?

Dokumentet e plotësuara së bashku me projekt-aktin dhe dokumentet tjera përcjellëse duhet të dërgohen në kopje fizike dhe elektronike në Departamentin e së Drejtës së BE-së të Ministrisë së Integritimit Evropian, e cila brenda afatit ligjor prej 15 ditë pune lëshon **Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me Acquis të BE-së** për projekt-aktin në fjalë. Departamenti i së Drejtës së BE-së është autoriteti kyç për ofrimin e çdo lloj asistence lidhur me çështjet e përafrimit të legjislacionit vendor me Acquis të BE-së në përgjithësi, si dhe në plotësimin e Tabelave të Përputhshmërisë dhe Deklaratës së Përputhshmërisë, në veçanti.

## 1.8. Në cilën gjuhë duhet të përgatiten këto dokumente?

Deklarata e Përputhshmërisë duhet të përgatitet nga organi propozues në tri gjuhë: shqipe, serbe dhe angleze.

Në mungesë të versioneve të përkthyer dhe të certifikuara të akteve të Acquis të BE-së, **Tabelat e Përputhshmërisë duhet të hartohen vetëm në gjuhën angleze**. Në të ardhmen, pas përkthimit dhe certifikimit zyrtar të këtyre akteve ato do të mund të hartohen edhe në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Ministria e Integritimit Evropian është autoriteti kryesor për përkthimin dhe certifikimin e versioneve të përkthyer të Acquis të BE-së.

## 2. TABELA E PËRPUTHSHMËRISË BASHKIMI EUROPIAN - REPUBLIKA E KOSOVËS

Në vijim janë paraqitur udhëzimet për plotësimin e Tabelës së Përputhshmërisë  
Bashkimi Evropian – Republika e Kosovës



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e \_\_\_\_\_  
Ministarstvo \_\_\_\_\_ - Ministry of \_\_\_\_\_

1. Emërtimi i aktit normativ: Direktiva e Këshillit ...  (Udhëzim: Në këtë pikë vendoset emërtimi i aktit të Acquis të BE-së)
2. Organi propozues: Komisioni Evropian
3. Tabela e punuar më: data/muaji/viti
4. Lista e legjislacionit përkatës vendor (titulli i plote i aktit, dhe numri) në të cilën është transpozuar akti përkatës i BE-së  (Udhëzim: Në këtë pikë vendosen të gjitha aktet normative vendore në të cilat janë transpozuar dispozitat e aktit të Acquis të BE-së të cekur në pikën 1 të kësaj Tabele. Ekzistojnë raste kur një akt i Acquis të BE-së transpozohet në dy ose më shumë akte normative vendore)
5. Shkalla e përafrimit (plotësisht i përputhshëm, pjesërisht i përputhshëm, i papërputhshëm apo i pa zbatueshëm) të aktit normativ me legjislacionin e BE-së:  (Udhëzim: Pas krahasimit të dispozitave të aktit të Acquis të BE-së me dispozitat e akteve normative vendore, detyrimisht duhet të përcaktohet shkalla e përgjithshme e përafrimit. Pra, shkalla e përafrimit në këtë pikë duhet të theksohet pas plotësimit të tabelës dhe vlerësimit të shkallës së përafrimit)

a)	b)	c)	d)
<p>Akti normativ i BE-se (neni, paragrafi, nenparagrafi, et.)</p> <p>(Udhëzim: Në këtë kolonë vendosen dispozitat e aktit të Acquis të BE-së. Këto dispozita duhet të ndahen fizikisht në ndarjen më të vogël të aktit respektiv (nen, paragraf, nën paragraf, etj). Rekomandohet që zyrtari përgjegjës të plotësojë së pari kolonën “a)” dhe pastaj kolonën “b)” të Tabelës, duke pasur parasysh ndarjen fizike të cekur si më lartë.</p>	<p>Dispozitat e aktit normativ të Kosovës (neni, paragrafi, nenparagrafi, et.)</p> <p>(Udhëzim: Në këtë kolonë vendosen dispozitat e aktit normativ vendor në të cilin janë transpozuar dispozitat e aktit të Acquis të BE-së. Në rastet kur transpozimi bëhet në dy ose më shumë akte normative vendore, atëherë para citimit të dispozitës konkrete të aktit vendor duhet të vendoset titulli i këtij akti dhe emërtimi i nenit përkatës të këtij akti.)</p>	<p>Përputhja e legjislacionit të BE-së në legjislacionin e Kosovës (plotësisht i përputhshëm, pjesërisht i përputhshëm, i papërputhshëm apo i pa zbatueshem)</p> <p>(Udhëzim: Pas krahasimit të aktit të Acquis të BE-së me aktin normativ vendor, për çdo nen (apo paragraf, nën paragraf) vlerësohet dhe shënohet shkalla e përputhshmërisë në njërin nga kategoritë e cekura më lartë)</p>	<p>Shenime për arsyet e përputhjes së pjesshme apo të mospërputhjes si dhe periudha e parashikuar për arritjen e përputhjes së plote.</p> <p>(Udhëzim: Në rastet kur dispozita e BE-së nuk është transpozuar apo është transpozuar pjesërisht me ç’rast niveli i përputhshmërisë vlerësohet si pjesërisht i përputhshëm apo i papërputhshëm, organi propozues duhet të paraqes këto informata:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Arsyen e përputhjes së pjesshme apo mospërputhjes.</li> <li>2. Afatin kohor kur dispozita e tillë pritet të transpozohet në legjislacionin vendor. Kjo informatë vendoset pas analizimit të mirëfilltë të prioriteteve të politikave që institucioni i ka vendosur.</li> </ol>



Në vijim është paraqitur shembulli i Tabelës së Përputhshmërisë Bashkimi Evropian – Republika e Kosovës, të plotësuar.

Vërejtje: Shembulli i mëposhtëm shërben vetëm për ilustrim të metodologjisë së plotësimit të Tabelës, andaj i njëjti nuk pasqyron dispozitat reale të legjislacionit në fjalë dhe shkallën reale të përputhshmërisë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit  
Ured Premijera - Office of the Prime Minister

6.	Emërtimi i aktit normativ: Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 korrik 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (e ndryshuar)
7.	Organi propozues: Komisioni Evropian
8.	Tabela e punuar më: 10 Mars 2015
9.	Lista e legjislacionit përkatës vendor (titulli i plote i aktit, dhe numri) në të cilën është transpozuar akti përkatës i BE-së <ul style="list-style-type: none"><li>- Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen kundër Diskriminimit</li><li>- Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore</li></ul>
10.	Shkalla e përafrimit (plotësisht i përputhshëm, pjesërisht i përputhshëm, i papërputhshëm apo i pa zbatueshëm) të aktit normativ me legjislacionin e BE-së:  Pjesërisht i përputhshëm

a)	b)	c)	d)
<p>Akti normativ i BE-se (neni, paragrafi, nenparagrafi, et.)</p>	<p>Dispozitat e aktit normativ të Kosovës (neni, paragrafi, nenparagrafi, et.)</p>	<p>Përputhjae legjislacionit të BE-së ne legjislacionin e Kosovës (plotësisht i përputhshëm, pjesërisht i përputhshëm, i papërputhshëm apo i pa zbatueshem)</p>	<p>Shenime per arsyet e përputhjes se pjesshme apo te mospërputhjes si dhe periudha e parashikuar për arrijten e përputhjes se plote.</p>
<p>Direktiva 2006/54/EC Neni 19 Barra e provës</p> <p>1. Shtetet Anëtare në përputhje me sistemet e tyre kombëtare gjyqësore marrin masa të tilla që janë të nevojshme për të siguruar për personat që janë dëmtuar për shkak se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre përpara një gjykate apo autoriteti tjetër kompetent, me ç`rast faktet nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë duhet të provohen nga i padituri për të dëshmuar se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.</p>	<p>Ligji për mbrojtjen kundër diskriminimit</p> <p>Neni 20 Barra e provave</p> <p>1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin fakte para organit administrativ apo gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.</p> <p>2. Barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.</p>	<p>Plotësisht i përputhshëm</p>	

<p>Neni 5 Ndalimi i Diskriminimit</p> <p>Pa paragjykuar Nenin 4, nuk duhet të ketë diskriminim direkt apo të tërthortë në bazë të gjinisë në skemat e sigurimit shoqëror në punë.</p>	<p>Ligji për Barazi Gjinore</p> <p>Neni 16 Ndalimi i diskriminimit gjinor në skemat e sigurimit shoqëror në punë</p> <p>1. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë në bazë të gjinisë në të gjitha skemat e sigurimit shoqëror në punë.</p>	<p>Pjesërisht i përputhshëm</p>	<p>Arsyeja e përputhjes së pjesërishtme është se Ligji për Barazinë Gjinore parasheh vetëm diskriminimin e drejtpërdrejtë, ndërsa jo dhe atë të tërthortë.</p> <p>Arsyeja e mos përfshirjes së diskriminimit të tërthortë konsiston në analizën dhe identifikimin e rasteve të mundshme të diskriminimit të tërthortë. Pas kësaj analize, pritet të formulohet përkufizimi i diskriminimit të tërthortë dhe i njëjtë të inkorporohet në dispozitat e këtij Ligji. Analiza është e parapare të përfundoj brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, ndërsa plotësim ndryshimi i Ligjit pritet të bëhet deri në Qershor 2016.</p>
---	--	---------------------------------	---

<p>Neni 2 Përkufizimet</p> <p>1.Për qëllime të kësaj Direktive, përkufizimet në vijim zbatohen:</p> <p>(b) “diskriminim i tërthortë”: kur një dispozitë dukshëm neutrale, kriter apo praktikë, e vë apo do ti vë personat e një gjinie në një disavantazh të veçantë në krahasim me personat e gjinisë tjetër, përveç nëse kjo dispozitë, kriter ose praktikë justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, dhe mjetet për arritjen e atij qëllimi janë të përshtatshme dhe të nevojshme;</p>		I papërputhshëm	Arsyeja për mos përputhje është e njëjta me komentën e cekur në komentën paraparak.
<p>Neni 35 Hyrja në fuqi</p> <p>Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi ditën e njëzetë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit European.</p>		I pazbatueshëm	

# 3. TABELA E PËRPUTHSHMËRISË REPUBLIKA E KOSOVËS – BASHKIMI EUROPIAN

Në vijim janë paraqitur udhëzimet për plotësimin e Tabelës së Përputhshmërisë  
Republika e Kosovës - Bashkimi Evropian



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e \_\_\_\_\_  
Ministarstvo \_\_\_\_\_ - Ministry of \_\_\_\_\_

Opsioni/alternativa e mundshme:

1. Emërtimi i aktit normativ: Ligji për xxx...
(Udhëzim: Në këtë pikë vendoset emërtimi i aktit normativ vendor)
2 Organi propozues: Ministria e xxx...
3. Tabela e punuar më: data/muaji/viti
4. Lista e legjislacionit përkatës të BE-së (titulli i plote i aktit, dhe numri)me te cilin ështëpërafruar akti normativ i Republikës së Kosovës
(Udhëzim: Në këtë pikë vendosen të gjitha aktet e Acquis të BE-së me të cilat është përafruar akti normativ vendor i cekur në pikën 1 të kësaj Tabele. Ekzistojnë raste kur një akt normativ vendor përafrohet me dy ose më shumë akte të Acquis të BE-së)
1. Shkalla e përafrimit (plotësisht i përputhshëm, pjesërisht i përputhshëm, i papërputhshëm apo i pa zbatueshëm) te aktit normativ me legjislacionin e BE-së:
(Udhëzim: Pas krahasimit të dispozitave të aktit normativ vendor me dispozitat e akteve normative të Acquis të BE-së, detyrimisht duhet të përcaktohet shkalla e përgjithshme e përafrimit. Pra, shkalla e përafrimit në këtë pikë duhet të theksohet pas plotësimit të tabelës dhe vlerësim-it të shkallës së përafrimit)

a)	b)	c)	d)
<p>Dispozitat e aktit notmativ të Kosovës (neni, paragrafi, nënparagrafi, et.)</p> <p>(Udhëzim: Në këtë kolonë vendosen dispozitat e aktit normativ vendor. Këto dispozita duhet të ndahen fizikisht në ndarjen më të vogël të aktit respektiv (nen, paragraf, nën paragraf, etj).</p>	<p>Akti normativ i BE-se (neni, paragrafi, nënparagrafi, et.)</p> <p>(Udhëzim: Në këtë kolonë vendosen dispozitat e aktit të Acquis të BE-së. Në rastet kur akti vendor është përafuar me dy ose më shumë akte të Acquis të BE-së, atëherë para citimit të dispozitës konkrete të aktit të Acquis të BE-së duhet të vendoset titulli dhe emërtimi i nenit përkatës të aktit të Acquis.)</p>	<p>Përputhja e legjislacionit të BE-së në legjislacionin e Kosovës (plotësisht i përputhshëm, pjesërisht i përputhshëm, i papërputhshëm apo i pa zbatueshëm)</p> <p>(Udhëzim: Pas krahasimit të aktit normativ vendor me aktin e Acquis të BE-së, për çdo nen (apo paragraf, nën paragraf) vlerësohet dhe shënohet shkalla e përputhshmërisë në njërin nga kategoritë e cekura si më lartë)</p>	<p>Shënime për arsyet e përputhjes së pjesshme apo të mospërputhjes si dhe periudha e parashikuar për arritjen e përputhjes së plote.</p> <p>(Udhëzim: Në rastet kur dispozita e aktit normativ vendor nuk është përafuar me aktin e Acquis të BE-së apo është përafuar pjesërisht, me ç' rast niveli i përputhshmërisë vlerësohet si pjesërisht i përputhshëm apo i papërputhshëm, organi propozues duhet të paraqes këto informata:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Arsyen e përputhjes së pjesërishtme apo mospërputhjes.</li> <li>2. Afatin kohor kur legjislacioni vendor pritet të përafrohet me legjislacionin e BE-së. Kjo informatë vendoset pas analizimit të mirëfilltë të prioriteteve të politikave që institucioni i ka vendosur.</li> </ol>

Në vijim është paraqitur shembulli i Tabelës së Përputhshmërisë Republika e Kosovës - Bashkimi Evropian, të plotësuar.

Vërejtje: Shembulli i mëposhtëm shërben vetëm për ilustrim të metodologjisë së plotësimit të Tabelës, andaj i njëjti nuk pasqyron dispozitat reale të legjislacionit në fjalë dhe shkallën reale të përputhshmërisë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit  
Ured Premijera - Office of the Prime Minister

1.	Emërtimi i aktit normativ: Ligji për Mbrojtjen kundër Diskriminimit
2.	Organi propozues: Zyra e Kryeministrit
3.	Tabela e punuar më: 10 Mars 2015
	Lista e legjislacionit përkatës të BE-së (titulli i plote i aktit, dhe numri) me të cilin është përafuar akti normativ i Republikës së Kosovës
	- Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 korrik 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (e ndryshuar)
	- Direktiva 2000/43/EC e 29 Qershor 2000 që implementon parimin e trajtimit të barabartë në mes të personave pavarësisht origjinës racore dhe etnike
4.	Shkalla e përafritimit (plotësisht i përputhshëm, pjesërisht i përputhshëm, i papërputhshëm apo i pa zbatueshëm) të aktit normativ me legjislacionin e BE-së:
	Pjesërisht i përputhshëm



a)	b)	c)	d)
<p>Dispozitat e aktit notmativ të Kosovës (neni, paragrafi, nënparagrafi, et.)</p>	<p>Akti normativ i BE-se (neni, paragrafi, nënparagrafi, et.)</p>	<p>Përputhja e legjislacionit të BE-së ne legjislacionin e Kosovës (plotësisht i përputhshëm, pjesërisht i përputhshëm, i papërputhshëm apo i pa zbatueshëm)</p>	<p>Shënime per arsyet e përputhjes se pjesshme apo te mospërputhjes si dhe periudha e parashikuar per arritjen e përputhjes se plote.</p>
<p><b>LIGJI PËR MBROJTJEN KUNDËR DISKRIMINIMIT</b></p> <p><b>Neni 13</b>  <b>Paditë për mosmarrëveshjet për diskriminimin</b></p> <p>2. Shoqatat, apo organizatat mund të inicojnë apo përkrahin procedura ligjore në emër të parashtruesit, me marrjen e pëlqimit e tyre, për zhvillimin e procedurave administrative apo gjyqësore të parapara për zbatimin e obligimeve nga ky ligj.</p>	<p><b>DIREKTIVA 2000/43/EC</b></p> <p>Neni 7</p> <p>2. 2. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që shoqatat, organizatat ose personat e tjerë juridik, të cilët në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ligji i tyre kombëtar kanë një interes legjitim në sigurimin që dispozitat e kësaj Direktive, mund të angazhohen, qoftë në emër ose në mbështetje të ankuesit, me aprovimin e tij ose të saj, në çdo procedurë gjyqësore dhe / ose administrative e parashikuar për zbatimin e detyrimeve sipas kësaj direktive.</p>	<p>Pjesërisht e përputhshme</p>	<p>Arsyeja e përputhshmërisë së pjesërishtme qëndron në faktin se në Ligjin për mbrojtjen kundër diskriminimit nuk është e paraparë mundësia që edhe personat tjerë juridik përveç asociacioneve dhe organizatave, të ushtrojnë padi për diskriminim. Përputhshmëria e plotë pritet të arrihet pas konsultimit me asociacionet e shoqatave tregtare, deri në fund të vitit 2015. Ndryshimet parashihet të përfshihen në Ligj, deri në Qershor të vitit 2016.</p>

<p><b>Neni 20</b> <b>Barra e provave</b></p> <p>1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin fakte para organit administrativ apo gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.</p> <p>2. Barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.</p>	<p><b>Direktiva 2006/54/EC</b> <b>Neni 19</b> <b>Barra e provës</b></p> <p>1. Shtetet Anëtare në përputhje me sistemet e tyre kombëtare gjyqësore marrin masa të tilla që janë të nevojshme për të siguruar për personat që janë dëmtuar për shkak se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre përpara një gjykate apo autoriteti tjetër kompetent, me çrast faktet nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë duhet të provohen nga i padituri për të dëshmuar se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.</p>	<p>Plotësisht i përputhshëm</p>	
<p><b>Neni 28</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p> <p>Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p>		<p>I pazbatueshëm</p>	

Në vijim janë paraqitur udhëzimet për plotësimin e Deklaratës së Përputhshmërisë së Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Acquis të BE-së



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e \_\_\_\_\_  
Ministarstvo \_\_\_\_\_ - Ministry of \_\_\_\_\_

## 4. DEKLARATË E PERPUTHSHMERISE SË LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME ACQUIS TË BE-së

1. Organi propozues i aktit normativ: (Udhëzim: Të vendoset emri i organit propozues)

2. Titulli i projekt aktit normativ (Udhëzim: Të vendoset titulli i projekt aktit normativ)

3. Përputhshmëria e aktit normativ me dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ose Marrëveshjes së Përkohshme

3.1 dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme në lidhje me përmbajtjen normative të aktit normativ. (Udhëzim: Të vendosen neni/nenet përkatëse të MSA-së së bashku me dispozitat që ndërlidhen me fushën të cilën e rregullon projekt akti normativ)

3.2 Afati kohor i përcaktuar për përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit në përputhje me dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme . (Udhëzim: Të vendoset Neni 74, vetëm paragrafi 1 dhe 2, i MSA-së që paraqet bazën e përgjithshme për përafrimin e legjislacionit vendor me acquis të BE-së, si dhe Neni 9 i MSA-së, vetëm rreshti i parë, që përcakton periudhën e përgjithshme të asociimit)

3.3 Vlerësimi i nivelit të përmbushjes së detyrimit /obligimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme. (Udhëzim: Të vlerësohet se në çfarë niveli ka kontribuar projekt akti normativ në implementimin e Nenit/Neneve të përcaktuara në pikën 3.1.)

3.4 Arsyet për përmbushjen të pjesshme, ose mosplotësimi/dështimi për përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme (Udhëzim: Të vendoset arsyetimi vetëm në rastet kur implementimi i Nenit/Neneve të përcaktuara në pikën 3.1. është i pjesshëm ose nuk ka fare implementim)

3.5 Ndërlidhja me Programin Kombëtar për Integrim PKI/ PKAA (në rastin aktual ndërlidhja me PVPE) (Udhëzim: Të përshkruhet ndërlidhja e projekt-aktit normativ me Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së, gjegjësisht me pjesën e Matricës/Masave Legjislative të PKZMSA)

#### 4. Përputhshmëria e legjislacionit me Acquis e BE-së

(Udhëzim: Në kuadër të kësaj pikë respektivisht pikave 4.1, 4.2 dhe 4.3 listohen burimet relevante të së drejtës së BE-së për projektaktin normativ vendor. Gjithashtu, është e detyrueshme të vlerësohet niveli i përputhshmërisë së projektaktit normativ vendor me çdo akt të listuar. Në rastet kur nuk ka Acquis të BE-së relevante për projektaktin në fjalë, atëherë këto pika plotësohen me shprehjen “Nuk zbatohet”)

##### 4.1 Lista e burimeve primare të së drejtës të BE-së dhe përputhshmëria me to

(Udhëzim: Burimet primare të Acquis të BE-së janë: Traktatet themeluese të BE-së, Traktatet e tjera kryesore si dhe parimet e përgjithshme të drejtës së BE-së)

##### 4.2 Lista e burimeve sekondare të së drejtës të BE-së dhe përputhshmëria me to.

(Udhëzim: Burimet sekondare të Acquis të BE-se janë: aktet e njëanshme ligjore të nxjerra nga institucionet e BE-së në bazë të rregullave të vendosura (Rregulloret, Direktivat, Vendimet, Rekomandimet dhe Opinionet), si dhe Konventat dhe Marrëveshjet midis BE-së dhe një vendi të tretë ose një organizate pale të tretë.

##### 4.3 Lista e burimeve tjera të së drejtës të BE dhe përputhshmëria me to.

(Udhëzim: Burim tjetër i së drejtës së BE-së është praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian)

##### 4.4 Arsytet për përputhje të pjesshme, apo mospërputhje.

(Udhëzim: Në rastet kur dispozita e aktit normativ vendor nuk është përafuar me aktet e Acquis të BE-se të cekura më lartë, apo është përafuar në mënyrë të pjesërishme, me ç'rast niveli i përputhshmërisë vlerësohet si pjesërisht i përputhshëm apo i papërputhshëm, organi propozues është i obliguar të paraqes arsyen e përputhjes së pjesërishme apo mospërputhjes.

##### 4.5 Periudha kohore brenda së cilës është e paraparë realizimi i plotë i përputhshmërisë të legjislacionit me Acquis e BE.

(Udhëzim - Në këtë pikë organi propozues është i obliguar të paraqes afatin kohor kur legjislacioni vendor pritet të përafrohet me aktet e Acquis të BE-së të cekura më lartë. Kjo informatë vendoset pas analizimit të mirëfilltë të prioriteteve të politikave që institucioni i ka vendosur.)

5. Të specifikohet kur nuk ka legjislacion të BE-së me të cilën përputhshmëria është e kërkuar. (Në këtë rast, nuk është e domosdoshme të plotësoni tabelën e përputhshmërisë së legjislacionit).

(Udhëzim - Në rastet kur ka akte të Acquis të BE-së relevante për projektaktin në fjalë, atëherë kjo pikë duhet të plotësohet me shprehjen “Nuk zbatohet”,

Nërsa në rastet kur nuk ka akte të Acquis të BE-së relevante për projektaktin në fjalë atëherë kjo pikë duhet të plotësohet me shprehjen “Nuk ka legjislacion të BE-së me të cilën përputhshmëria është e kërkuar”)

6. A janë burimet e lartpërmendura të së drejtës së BE-së të përkthyer në gjuhët zyrtare;

(Udhëzim: Në këtë pikë, organi propozues duhet të theksojë në rast se aktet e lartpërmendura të Acquis të BE-së janë të përkthyer në gjuhët zyrtare.

Në rast se ekzistojnë verzionet e përkthyer të cilat organi propozues i ka përdorur gjatë përafrimit të aktit normativ vendor me acquis të BE-së, atëherë duhet të theksohet nëse këto verzionet të përkthyer janë versione të certifikuara në përputhje me Rregulloren Nr. 02/2015 për Procesin e Përkthimit të Acquis të BE-së në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në rast se këto verzionet nuk janë zyrtare apo të certifikuara, organi propozues duhet të theksojë autoritetin i cili i ka përkthyer këto akte (p.sh. përkthyes të brendshëm të institucionit; përkthyes të jashtëm të kontraktuar; projekte të ndryshme; donatorë, etj).

Në rast se nuk ka verzionet të përkthyer të këtyre akteve, organi propozues duhet të theksojë se aktet e lartpërmendura të Acquis të BE-së nuk janë të përkthyer në gjuhët zyrtare.)

7. Pjesëmarrja e konsulentëve në hartimin e akteve normative dhe mendimin e tyre për përputhshmërinë (të bashkëngjitur shkresat e konsulentëve për hartimin e akteve normative).

(Udhëzim – Në këtë pikë organi propozues duhet të theksojë emrin e konsulentit të përfshirë në hartimin e projekt aktit, institucionin ose projektin të cilin e përfaqëson dhe të bashkëngjiten komentet e dhëna me shkrim)

8. Nënshkrimi i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor të organit shtetëror, ose propozuesit tjetër të aktit normativ.

(Udhëzim – Nënshkrimi është i obligueshëm)

9. Nënshkrimi i Ministrit apo udhëheqësit të organit shtetëror, ose propozuesit tjetër të aktit normativ.

(Udhëzim – Nënshkrimi dhe vula janë të obligueshme)

Nënshkrimi, data dhe vula

Në vijim është paraqitur shembulli i Deklaratës së Përputhshmërisë së Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Acquis të BE-së

Vërejtje: Shembulli i mëposhtëm shërben vetëm për ilustrim të metodologjisë së plotësimit të Deklaratës, andaj i njëjti nuk pasqyron informatat reale dhe shkallën reale të përputhshmërisë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit  
Ured Premijera - Office of the Prime Minister

## DEKLARATË E PERPUTHSHMERISE SË LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME ACQUIS TË BE-së

1. **Organi propozues i aktit normativ:** Zyra e Kryeministrit
2. **Titulli i projekt aktit normativ:** Ligji për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit
3. **Përputhshmëria e aktit normativ me dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ose Marrëveshjes së Përkohshme**

**3.1 dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme në lidhje me përmbajtjen normative të aktit normativ.**

### Neni 4

Kosova angazhohet të respektojë të drejtën dhe instrumentet ndërkombëtare, por jo vetëm ato që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore, e deri tek mbrojtja e personave që u përkasin minoriteteve dhe pa diskriminim mbi çfarëdo baze.

### Neni 106

#### Bashkëpunimi social

“Palët do të bashkëpunojnë për lehtësimin e reformave të politikave të punësimit në Kosovë, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe të integritit dhe me qëllim të mbështetjes të rritjes përfshirëse. Bashkëpunimi do të synon nxitjen e dialogut social si dhe përafrimin gradual ligjor të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së për punën, shëndetin, sigurinë në punë dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, për personat me aftësi të kufizuara dhe për personat që i përkasin grupeve minoritare dhe grupeve të tjera të cënueshme, duke ju referuar nivelit ekzistues të mbrojtjes në BE. Kjo mund të përfshijë përafrimin e Kosovës me acquis të BE-së në fushën e ligjit të punës dhe në lidhje me kushtet e punës për gratë. Bashkëpunimi gjithashtu do të nxisë miratimin e inkuadrimin gjithëpërfshirës social dhe politikave kundër-diskriminimit në Kosovë...”

### **Neni 107** **Arsimi dhe trajnimi**

“...Palët bashkëpunojnë gjithashtu për të garantuar që qasja në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Kosovë të mos i nënshtrohet diskriminimit në bazë të gjinisë, origjinës racore apo etnike, fesë apo besimit, aftësisë së kufizuar, moshës apo orientimit seksual. Bashkëpunimi do synoj trajtimin e nevojave të studentëve me aftësi të kufizuara në Kosovë.”

### **3.2 Afati kohor i përcaktuar për përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit në përputhje me dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme.**

#### **Neni 74**

1. Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues të Kosovës me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv. Kosova do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkoj gradualisht drejt përputhjes me *acquis-in* e BE-së. Kosova do të sigurohet se ligjet ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të implementohet dhe zbatohet siç duhet.

2. Ky përafrim do të fillon në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementët e *acquis-it* të BE-së të cekura në këtë Marrëveshje deri në fund të periudhës transitore të përcaktuar në nenin 9.

#### **Neni 9**

Asociimi në mënyrë progresive dhe të plotë do të realizohet gjatë një periudhe prej dhjetë vitesh.

### **3.3 Vlerësimi i nivelit të përmbushjes së detyrimit /obligimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme.**

Institucioni propozues vlerëson se me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit do të implementohen në mënyrë të konsiderueshme Nenet e cekura në pikën 3.1.

### **3.4 Arsyet për përmbushjen të pjesshme, ose mosplotësimi/dështimi për përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme.**

Ligji për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit nuk ka transpozuar plotësisht standardet e përcaktuara të legjislacionit të BE-së siç kërkohet nga MSA, për arsyet e cekura në pikën 4.4

### **3.5 Ndërlidhja me Programin Kombëtar për Integrim PKI/PKAA (në rastin aktual ndërlidhja me PVPE)**

Ligji për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit është paraparë në masat afatshkurta legjislative në kuadër të PKZMSA-së, përkatësisht në kuadër të objektivave 3.24, faqe 430 PKZMSA.

Legjislacioni i BE-së i cekur që do të transpozohet pjesërisht në këtë Ligj është Direktiva 2006/54/EC dhe Direktiva 2000/43/EC. Institucion përgjegjës është Zyra e Kryeministrit, ndërsa afati është K4 2016.

#### 4. **Përputhshmëria e legjislacionit me Acquis e BE-së:** Pjesërisht në Përputhje

##### 4.1 **Lista e burimeve primare të së drejtës të BE-së dhe përputhshmëria me to:**

Nuk ka burime primare të së drejtës së BE-së që e mbulojnë këtë fushë.

##### 4.2 **Lista e burimeve sekondare të së drejtës të BE-së dhe përputhshmëria me to.**

- Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 korrik 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (e ndryshuar) – Pjesërisht në përputhje
- Direktiva 2000/43/EC e 29 Qershor 2000 që implementon parimin e trajtimit të barabartë në mes të personave pavarësisht origjinës racore dhe etnike - Pjesërisht në përputhje

##### 4.3 **Lista e burimeve tjera të së drejtës të BE dhe përputhshmëria me to.**

Nuk ka burime të tjera të së drejtës së BE-së që e mbulojnë këtë fushë.

##### 4.4 **Arsyet për përputhje të pjesshme, apo mospërputhje.**

Arsyet e përputhjes së pjesërishtme janë:

- a) Legjislacioni vendor parasheh vetëm diskriminimin e drejtpërdrejtë, ndërsa jo edhe atë të tërthortë;
- b) Në Ligjin për mbrojtjen kundër diskriminimit nuk është e paraparë mundësia që edhe personat tjerë juridikë përveç asociacioneve dhe organizatave, të ushtrojnë padi për diskriminim.

##### 4.5 **Periudha kohore brenda së cilës është e paraparë realizimi i plotë i përputhshmërisë të legjislacionit me Acquis e BE.**

Qershor 2016 për të dy pikat.

#### 5. **Të specifikohet kur nuk ka legjislacion të BE-së me të cilën përputhshmëria është e kërkuar.** Nuk zbatohet

#### 6. **A janë burimet e lartpërmendura të së drejtës së BE-së të përkthyer në gjuhët zyrtare;** Nuk janë të përkthyer

#### 7. **Pjesëmarrja e konsulentëve në hartimin e akteve normative dhe mendimin e tyre për përputhshmërinë (të bashkangjitur shkresat e konsulentëve për hartimin e akteve normative).**

Projekti i përbashkët mes Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës i titulluar “Rivlerësimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë”. Deklaratës së përputhshmërisë i bashkëngjiten shkresat të cilat përfshijnë rekomandimet e projektit në fjalë.

#### 8. **Nënshkrimi i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor të organit shtetëror, ose propozuesit tjetër të aktit normativ.**

#### 9. **Nënshkrimi i Ministrit apo udhëheqësit të organit shtetëror, ose propozuesit tjetër të aktit normativ.**

Nënshkrimi, data dhe vula



## 5. UDHËZIME SHITESË

- Formati i faqes së Tabelave të Përputhshmërisë duhet të jetë horizontal “landscape” meqë ka më shumë hapësirë për të lexuar dhe shkruar në kolona më të gjata, si dhe krahasimi bëhet më lehtë. Verzionet “landscape” të Tabelave të Përputhshmërisë mund të gjenden në linkun: <http://www.mei-ks.net/sq/parafrimi-i-legjislacionit-vendor-me-legjislacion-te-be-se> Shtojcat 16 dhe 17. Tabelat duhet të plotësohen duke u bazuar në këtë shembull dhe nuk lejohet ndryshimi i formatit, stilit të shkronjave apo diçka tjetër.
- Teksti i aktit të Acquis të BE-së dhe akti normativ vendor vendosen në tërësi duke filluar nga Neni 1, në Tabelat e Përputhshmërisë BE – Republika e Kosovës dhe Republika e Kosovës - BE. Nuk lejohet përdorimi i inicialeve gjatë plotësimit të tabelave. Përmbajtja e vendosur në tabela duhet të jetë identike me përmbajtjen e aktit relevant.
- Në rastet kur në tabelat e përputhshmërisë citohen dy ose më shumë akte normative vendore, apo dy ose më shumë akte të Acquis të BE-së, atëherë para çdo neni konkret të këtyre akteve duhet të theksohet edhe titulli i plotë i aktit, ashtu siç është e paraparë në shembullin e Tabelave të ilustruara si më lartë.
- Në rastet kur transpozohet legjislacioni i BE-së, në dispozitën e qëllimit (Neni 1) të aktit normativ vendor, duhet të listohet legjislacioni i BE-së, i cili është transpozuar gjatë hartimit të aktit normativ siç përcaktohet në Shtojcën nr. 13 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.
- Për informata më të hollësishme për procesin e parafrimit dhe përkthimit të Acquis të BE-së, vizitoni <http://mei-ks.net/sq/parafrimi-dhe-perkthimi-i-legjislacionit-te-be-se-ne-kosove>